

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7957
E premte, 20 dhjetor 2024
Çmimi 0.50

KMDLNj-ja reagon për rastet e fundit të kërcënimit për vrasje në Kosovë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

WISNERI: KOSOVA DUHET TË KRIJOJË NJË ASOCIACION ME PËRGJEGJËSI SHUMË TË KUFIZUARA

FAQE 4-5



Ish-emisari i Shteteve të Bashkuara në bisedimet për statusin e Kosovës, Frank Wisner, thotë se Kosova duhet të krijojë një asociacion të komunave me shumicë serbe, me përgjegjësi

shumë të kufizuara në kulturë, arsim, taksa dhe gjëra të tilla, por që nuk ka status sovran që do ta prishte funksionimin e shtetit të Kosovës. Në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë", Wisneri

beson se është ende herët të thuhet se çfarë mund të pritët nga administrata e presidentit të zgjedhur amerikan, Donald Trump, në lidhje me Ballkanin Perëndimor

ASK-ja: KOSOVA KA 1 586 659 BANORË TË REGJISTRUAR

F. 3



KOSOVA MERR KRYESIMIN E FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR (WBF)

F. 6



AKTUALE



SHBA-ja DHE BE-ja VLERËSOJNË PUNËN E SPAK-UT NË PESËVJETORIN E THEMELIT TË TIJ

F. 2

KRASNIOI, ABDIXHIKU DHE HARADINAJ PRESIN NË TAKIM LANTUMIRËS AMBASADORIN HOVENIER

F. 3

OSMANI: SAMITI BE - BALLKANI PERËNDIMOR MBETET NJË PLATFORMË E RËNDËSISHME PËR RAJONIN TONË

F. 3

EKONOMI



MANDARINAT NGA SHQIPËRIA, ME MBETJE TË PESTICIDEVE TË RREZIKSHME

F. 8

ALIU: MJEGULLA DHE MOTI I KEQ NUK NDALOJNË MË FLUTURIMET FALË TEKNOLOGJISË SË RE NË AEROPORTIN E PRISHTINËS

F. 8

SPORT



SOT PËRBALLJA LLAPI - DUKAGJINI, KATËR NDESHJET E TJERA NË FUNDJAVË

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja dhe BE-ja vlerësojnë punën e SPAK-ut në pesëvjetorin e themelimit të tij

TIRANË, 19 DHJETOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian e kanë mbështetur dhe përshëndetur punën e Prokurorisë së Posaçme në Shqipëri (SPAK) në pesëvjetorin e themelimit të saj, por kanë theksuar se pavarësia e saj mbetet gjëja më e rëndësishme.

Zëvendësi i ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kasanof, tha se gjatë një vizite së tij të parë në Shqipëri, bëri thirrje që prokurorëve të SPAK-u t'u mundësohet aplikimi për vazhdimin e mandatit. "Pavarësia e SPAK-ut mbetet vendimtare. Për t'u siguruar që SPAK-u të vijojë në të ardhmen luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ne besojmë se prokurorët e SPAK-ut duhet të lejohen të aplikojnë sërish pas përfundimit të mandatit të tyre aktual", tha Kasanof.

Prokurorët e SPAK-ut kanë të drejtë për vetëm një mandat nëntëvjeçar, sipas Kushtetutës së Shqipërisë.

Kasanof tha se dështimi për t'ua mundësuar atyre vazhdimin e mandatit "rezikon ta ndërpresë



përpjekjen më të suksesshme kundër krimit të organizuar e korrupsionit në historinë shqiptare".

Pak muaj më parë të njëjtën kërkesë e kishte bërë edhe kreu i SPAK-ut, Altin Dumani, duke i kërkuar Kuvendit të bëjë ndryshime kushtetuese për t'i lejuar prokurorët të kandidojnë për vazhdimin e mandatit.

Ndërkohë, ambasadori i

Bashkimit Evropian në Tiranë, Silvio Gonzato, garanoi vijimin e mbështetjes për SPAK-un dhe kujtoi se rrugëtimi evropian i Shqipërisë bazohet në rezultatet e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ai kërkoi që SPAK-u të mos lihet i vetëm në këtë luftë. "SPAK-u nuk është dhe s'duhet të jetë institucioni i vetëm në luftën kundër korrupsionit dhe krimit

të organizuar. Është përgjegjësi e të gjitha institucioneve. Duhet të jetë përpjekje e bashkënduar", tha Gonzato. Në ceremoninë e pesëvjetorit të institucionit që drejton, Dumani tha se gjatë kësaj kohe Prokuroria e Posaçme ka provuar se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

Gjatë kësaj kohe para gjyqit kanë dalë disa ish-zyrtarë, ish-

ministra e deputetë dhe ata tashmë po vuajnë dënimin.

Kreu i SPAK-ut dhe institucioni që drejton janë përballur kohët e fundit me sulme nga politika. Ish-kryeministri Sali Berisha dhe ish-presidenti Ilir Meta, që të dy nën hetim për korrupsion, kanë pretenduar se Dumani i shërben qeverisë dhe se, sipas tyre, po e godet opozitën.

Në rezultatet e punës së SPAK-ut, Dumani, i cili e mori detyrën para dy vjetësh, renditi si arritje sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve me vlerë deri në 182 milionë euro.

Gjithashtu janë proceduar 61 zyrtarë të lartë për korrupsion, nga të cilët 70 % janë dërguar në gjykim. Sa i përket krimit të organizuar, janë proceduar 955 persona, ndërsa në fushën e terrorizmit janë proceduar 29 persona dhe të gjithë janë dërguar për gjykim.

Dumani u nderua nga Departamenti Amerikan i Shtetit si kampion në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri javë më parë.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, teksa i dha çmimin Dumanit, e vlerësoi SPAK-un institucionin më të besueshëm në Shqipëri.

HRW: Mohimi i ujit në Gazë nga Izraeli, akt gjenocidi

GAZA, 19 DHJETOR - Organizata për të Drejtat e Njeriut, Human Rights Watch (HRW), ka thënë të enjten se Izraeli i ka vrarë mijëra palestinezë në Rripin e Gazës duke ua mohuar ujin e pastër. Kjo, shtoi HRW-ja, përbën akte gjenocidi dhe shfarosjeje. "Kjo politikë, e sjellë si pjesë e vrasjes masive të civilëve palestinezë në Gazë, nënkupton se autoritetet izraelite kanë kryer krim kundër njerëzimit, shfarosje, gjë që po vazhdon. Kjo politikë përbën edhe 'vepër gjenocidi' sipas Konventës së Gjenocidit nga viti 1948", tha HRW-ja në një raport.

Izraeli i ka hedhur poshtë vazhdimisht akuzat për gjenocid, duke thënë se e respekton ligjin ndërkombëtar dhe se ka të drejtë ta mbrojë veten, pas sulmit që Hamasi e kreu në jug të Izraelit më 7 tetor 2023, i cili e nxiti luftën në Gazë.

Hamasi është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Në një reagim në X, Ministria e Jashtme e Izraelit shkroi: "E vërteta është e kundërta e gënjeshtërve të HRW-së". "Që nga fillimi i luftës Izraeli e ka lehtësuar rrjedhën e



vazhdueshme të ujit dhe ndihmave humanitare në Gazë, pavarësisht se është përballur me sulme të vazhdueshme nga organizata terroriste e Hamasit", thuhet në reagimin e Izraelit.

Edhe pse në raport u përshkrua mohimi i ujit për civilët si akt gjenocidi, në të theksohet se nevojitet përcaktimi i qëllimit të zyrtarëve izraelitë për ta provuar krimin e gjenocidit kundër tyre. Raporti citoi deklaratat e disa zyrtarëve të lartë të Izraelit, për të cilët tha

se sugjeruan se "duan t'i shkatërrojnë palestinezët", që nënkupton se mohimi i ujit "mund të përbëjë krim gjenocidi". "Ne kemi gjetur se Qeveria e Izraelit po i vret qëllimshëm palestinezët në Gazë duke ua mohuar ujin që u nevojitet për të mbijetuar", tha drejtoresha e HRW-së për Lindjen e Mesme, Lama Fakih. Izraeli u përgjigj duke thënë se është siguruar që infrastruktura e ujit të jetë funksionale. Ai tha se partnerët ndërkombëtarë kanë dërguar

cisterna uji përmes pikëkalimeve izraelite, përfshirë edhe në javën e fundit, dhe se Izraeli e ka lehtësuar futjen e më shumë se 1.2 milion tonë furnizimesh në Gazë.

Human Rights Watch është grupi i dytë i madh për të drejtat e njeriut që brenda një muaji e përdor fjalën gjenocid për t'i përshkruar veprimet e Izraelit në Gazë, pasi Amnesty International tha në një raport se Izraeli po kryen gjenocid. Konventa e Gjenocidit e vitit

1948, e miratuar pas vrasjes masive të hebrenjve gjatë Holokaustit nazist, e përkufizon krimin e gjenocidit si "akte të kryera me qëllim për ta shkatërruar, në tërësi ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar".

Raporti prej 184-faqesh i Human Rights Watch tha se qeveria izraelite ndaloi furnizimin me ujë në Gazë, ndërpreu energjinë elektrike dhe kufizoi furnizimin me karburant, gjë që bëri që ujësjellësit dhe kanalizimet në Gazë të mos mund të përdoreshin.

Si pasojë, palestinezët në Gazë kishin qasje në vetëm disa litra ujë në ditë në shumë zona, shumë më pak se pragu prej 15 litrave që nevojiten për mbijetesë, tha grupi.

Lufta e Izraelit në Gazë i ka lënë të vdekur mbi 45 000 palestinezë, shumica e të cilëve gra dhe fëmijë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë.

Ushtria izraelite ka thënë se i ka vrarë mbi 17 000 militantë, pa dhënë dëshmi për këtë.

Lufta filloi kur militantët e Hamasit e sulmuan Izraelin jugor më 7 tetor 2023, ku i vranë rreth 1 200 njerëz, kryesisht civilë, dhe i rrëmbyen afër 250 të tjerë.

Ismet Bahtijari pranon fajësinë për frikësim të dëshmitarit dhe pengim të drejtësisë

HAGË, 19 DHJETOR - Ish-pjesëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ismet Bahtijari, e ka pranuar fajësinë për frikësim të dëshmitarit dhe pengim të drejtësisë, të enjten para Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, si dhe është pajtuar me një dënim deri në dy vjet burgim.

Bahtijari e ka bërë këtë nëpërmjet një marrëveshjeje për pranim të fajësisë që e ka

arritur me Prokurorinë e Specializuar. Ai akuzohet se, së bashku me Haxhi Shalën dhe Sabit Jonuzin, kishin bashkëpunuar për ta nxitur një dëshmitar për të mos dëshmuar para Gjykatës Speciale.

Deri më tani nuk është bërë me dije se për cilin dëshmitar bëhet fjalë apo në cilin rast ka qenë e paraparë të dëshmojë ai. "Fajtor", tha Bahtijari para panelit gjyqësor kur u pyet të

deklarohet për akuzat kundër tij, në seancën e datës 19 dhjetor.

Me këtë marrëveshje, ndër të tjera, Bahtijari u pajtua që në rast se gjykata e dënon me dy vjet burgim ose më pak, ai nuk do të ketë të drejtë apelimi ndaj këtij vendimi. Një ditë më parë edhe Shala dhe Jonuzi e pranuan fajësinë në gjykatë pas marrëveshjeve që arritën veç e veç me Prokurorinë.



ASK-ja: Kosova ka 1 586 659 banorë të regjistruar

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kosova i ka 1 586 659 banorë të regjistruar, sipas raportit përfundimtar të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për regjistrimin e popullsisë për vitin 2024.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit të ASK-së, Avni Kastrati, tha në një konferencë për medie në Prishtinë, se ASK-ja e ka bërë vlerësimin për komunat me shumicë serbe në veri të vendit, ku kryesisht u bojkotua procesi. Ai tha se ASK-ja vlerëson se Kosova ka një popullsi të përgjithshme rezidente prej 1 602 515.

Numri i saktë i banorëve në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës nuk është i njohur, megjithatë gjatë procesit të fundit të votimit atje në prill, të drejtë vote kishin 46 556 qytetarë, këtu përfshihen edhe vendet ku jeton komuniteti shqiptar.

Sipas të dhënave zyrtare nga regjistrimi i kaluar i popullsisë i realizuar më 2011, numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë ishte rreth 1.7 milion. Proces i edhe në atë kohë ishte bojkotuar në masë të madhe nga serbët.

Censusi i vitit 2024 tregon se struktura etnike në Kosovë mbetet pothuajse e njëjtë si në vitin 2011, me shqiptarët që përbëjnë shumicën e popullsisë dhe pakicat që ruajnë praninë e konsiderueshme, tha ASK-ja. Shumica e banorëve janë deklaruar se i përkasin besimit islam, ndërsa komunitetet ortodokse dhe katolike përfaqësojnë grupet më të mëdha të minoriteteve fetare,



sipas ASK-së.

Sipas të dhënave, 11 417 njerëz u vranë, 1 047 u zhdukën, 6 682 u plagosën dhe 3 312 u burgosën në periudhën shkurt 1998 - qershor 1999.

Ndërkohë, 154 272 ekonomi familjare kanë pësuar dëme në pronë gjatë luftës.

Vlera e dëmeve vetëm në ekonomi familjare, përjashtuar institucionet publike vlerësohet të jetë mbi pesë miliardë euro, sipas censusit.

Periudha e luftës përkufizohet prej 28 shkurtit 1998 deri më 11 qershor 1999, thuhet në raportin e ASK-së.

Kastrati tha se ASK-ja vlerëson se për dëmet në njerëz dhe në pronë gjatë luftës ka nënraportim, "sepse jo të gjithë njerëzit që ishin në luftën e viteve 1998-99 kanë qenë të pranishëm në censusin e vitit 2024".

Sipas raportit përfundimtar, mosha mesatare e popullsisë në Kosovë tani është 34.84

vjeçe, krahasuar me 29.97 vjeçe në vitin 2011.

Të dhënat tregojnë se 92.8 për qind e banorëve në Kosovë kanë në pronësi banesat e tyre, ndërsa rreth 5.3 për qind jetojnë me qira.

Raporti ka gjetur një ulje prej 26.6-përqindësh në madhësinë e ekonomisë familjare në vitin 2024 krahasuar me regjistrimin e fundit të vitit 2011.

Tani në Kosovë numri mesatar i personave në ekonomi familjare është 4.33 për qind,

krahasuar me 5.90 për qind në vitin 2011.

Në këto të dhëna nuk përfshihet numri i pjesëtarëve të diasporës, pasi procesi i regjistrimit të tyre ende po vazhdon.

Aktualisht, sipas ASK-së, në diasporë janë regjistruar rreth 550 000 persona.

Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, u zhvillua në të gjitha komunat e Kosovës nga 5 prilli deri më 24 maj.

Osmani: Samiti BE - Ballkani Perëndimor mbetet një platformë e rëndësishme për rajonin tonë

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Samiti BE - Ballkani Perëndimor mbetet një platformë e rëndësishme për rajonin tonë. "Andaj, në biseda me liderë të institucioneve dhe shteteve anëtare të BE-së, theksova se e ardhmja e Kosovës në BE është e pashmangshme e për ne mbetet një angazhim i

çdoditshëm. Nëse respektohet parimi i meritokracisë, ashtu siç proklamohet, atëherë duhet të ecet përpara me hapa konkretë në këtë rrugëtim, duke filluar me trajtimin e menjëhershëm të aplikacionit tonë për anëtarësim dhe heqjen e masave ndaj Kosovës të cilat janë të padrejta dhe joevropiane. Nuk mund të ketë integritet të suksesshëm të

vendeve të Ballkanit Perëndimor nëse vazhdimisht rrezikohet paqja dhe siguria. Prandaj, llogaridhënia e Serbisë për aktet e vazhdueshme të agresionit ndaj Kosovës është kyçe. Pavarësisht prej sfidave, Kosova nuk heq dorë nga integritimi në institucione euroatlantike sepse, mbi të gjitha, ky është vullneti i popullit tonë", ka thënë Osmani.





Wisneri: Kosova duhet të krijojë një asociacion me përgjegjësi shumë të kufizuara

Ish-emisari i Shteteve të Bashkuara në bisedimet për statusin e Kosovës, Frank Wisner, thotë se Kosova duhet të krijojë një asociacion të komunave me shumicë serbe, me përgjegjësi shumë të kufizuara në kulturë, arsim, taksa dhe gjëra të tilla, por që nuk ka status sovran që do ta prishte funksionimin e shtetit të Kosovës. Në një intervistë dhënë “Radios Evropa e Lirë”, Wisneri beson se është ende herët të thuhet se çfarë mund të pritët nga administrata e presidentit të zgjedhur amerikan, Donald Trump, në lidhje me Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Ish-emisari i Shteteve të Bashkuara në bisedimet për statusin e Kosovës, Frank Wisner, thotë se Kosova sot është një histori e përzier - “nuk ka arritur gjithçka që ka dëshiruar, por e ka ndërtuar veten si një shtet sovran në familjen evropiane”. Në një intervistë dhënë “Radios Evropa e Lirë”, Wisneri thotë se Serbia, ende sot e kësaj dite, nuk është e gatshme ta pranojë realitetin e një Kosove të pavarur, ndaj edhe marrëveshjet e arritura mes dy vendeve, sipas tij, nuk funksionojnë. Për arsyet e veta thotë se Kosova

duhet ta krijojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, por me “përgjegjësi shumë të kufizuara”. Wisneri beson se është ende herët të thuhet se çfarë mund të pritët nga administrata e presidentit të zgjedhur amerikan Donald Trump në lidhje me Ballkanin Perëndimor. “Administrata e mëparshme e Trumpit ka pasur një sërë idesh, që synonin arritjen e një marrëveshjeje territoriale... Çdo lëvizje drejt këtij objekti nuk do të shkaktonte gjë tjetër veçse telashe në Ballkanin Perëndimor. Shpresoj që kjo

nuk do ta tundojë administratën e re”, thotë ai.

Ambasador Wisner, dy dekada më parë ju ishit një figurë kyçe në negociatat për statusin e Kosovës. Mbi 25 vjet nga lufta dhe në prag të 17-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, si do ta vlerësonit përparimin e saj ndër vite?

Frank Wisner: Kosova e ka arritur pavarësinë e saj - një ëndërr të kamotshme - e ka ndërtuar veten si një komb i pavarur dhe ka hyrë pjesërisht në familjen e kombeve. Por, ajo është kundërshtuar vazhdimisht nga Serbia, e cila nuk e ka njohur pavarësinë e saj. Si rezultat, Serbia ka arritur ta bllokojë anëtarësimin e saj në Kombet e Bashkuara dhe një numër shtetesh nuk e kanë njohur. Por, në të njëjtën kohë, Kosova ka arritur që si vend i ri ta përmirësojë gjendjen e saj ekonomike dhe t'i përmirësojë institucionet e saj politike.

Në retrospektivë, a besoni se Kosova ka mundur të bëjë ndonjë gjë ndryshe, që mund ta kishte përmirësuar situatën e saj sot?

Frank Wisner: Jo. Kam menduar shpesh për këtë, por Serbia ka qenë shumë e vendosur për ta

bllokuar pavarësinë e Kosovës. Ka qenë e pamundur të kapërcehej ajo pengesë. Kundërshtimi i saj ndaj pavarësisë së Kosovës nuk është qetësuar për asnjë minutë gjatë këtyre viteve. Dhe, derisa Serbia ta pranojë faktin se Kosova është sovraane dhe e pavarur dhe është e gatshme të zhvillojë marrëdhënie të mira fqinjësore me të, unë nuk pres ndonjë zgjidhje mes tyre. Institucionet evropiane janë përpjekur shumë për t'i ndihmuar dy palët që ta pranojnë njëra-tjetrën dhe nuk ia kanë dalë. Shtetet e Bashkuara nuk ia kanë dalë. Derisa Serbia të bindet se është në interesin e saj që ta lejojë Kosovën të jetë një vend plotësisht i pavarur, nuk do të ndodhë asgjë, statusi përfundimtar nuk do të arrihet.

E kanë thënë edhe ndërmjetësuesit ndërkombëtarë se dy shoqëritë nuk janë ende gati për marrëveshje përfundimtare. Ju a mendoni se ka rrugëdalje?

Frank Wisner: Serbia, në veçanti, nuk është gati të pranojë se Kosova nuk është më pjesë e Serbisë dhe ta pranojë pavarësinë e saj. Derisa të arrihet kjo, nuk shoh zgjidhje të statusit përfundimtar.

E si mund të arrihet? A mendoni se Plani i Ahtisaarit është ende korniza më e mirë për marrëdhëniet Kosovë - Serbi? Apo duhet të ketë propozime të reja?

Frank Wisner: Unë mendoj se Plani i Ahtisaarit ishte i mirë. Nuk ka asgjë të keqe. Problem nuk është plani, por mosgatishmëria e Serbisë për ta pranuar faktin se Kosova është e pavarur. Kosova nuk do të jetë e kënaqur me asgjë më pak se pavarësia.

“Asociacion me përgjegjësi të kufizuara”

Formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është një marrëveshje e arritur në dialog, por që nuk është zbatuar ende nga Kosova. Qeveria aktuale e Kosovës ka frikë se mund të duket diçka si Republika Sërpska. Ju a e justifikoni këtë frikë?

Frank Wisner: Unë besoj se ideja e komunave [me shumicë] serbe, që të punojnë së bashku, të bashkëpunojnë, t'i ruajnë institucionet kulturore, është mjaft e mirë. Por, unë kurrë nuk kam qenë plotësisht i bindur se Serbia e shikon atë marrëveshje si pjesë të një Kosove të pavarur.

Ajo më shumë e sheh si mënyrë për ta reduktuar pozitën e Kosovës si shtet i pavarur. Pra, ideja në parim mbetet e mirë, por derisa nuk shoh një vullnet më të madh të Serbisë për të jetuar me një Kosovë të pavarur, unë nuk pres që ndonjë marrëveshje të funksionojë, të mbahet apo të jetë e suksesshme.

Pra, a mendoni se Kosova duhet ta formojë Asociacionin?

Frank Wisner: Unë mendoj se Kosova, për arsyet e veta, duhet të krijojë një asociacion të komunave me shumicë serbe, me përgjegjësi shumë të kufizuara në kulturë, arsim, taksa dhe gjëra të tilla, por që nuk ka status sovran që do ta prishte funksionimin e shtetit të Kosovës.

ShBA-ja, si aleatja më e afërt e Kosovës, ka qenë kritike ndaj qeverisë aktuale, kryesisht për shkak të disa veprimeve të saj në veri të Kosovës, si heqja nga përdorimi e dinarit serb, mbyllja e institucioneve paralele serbe... Qeveria i ka cilësuar ata hapa si shtrirje të autoritetit ligjor, por ShBA-ja dhe pjesa tjetër e komunitetit ndërkombëtar kanë thënë se nuk është koha e duhur për ta. Ju, si mendoni?

Frank Wisner: Unë mendoj se është koha e duhur për t'i shtrirë të gjitha përgjegjësitë

sovrane të një vendi të pavarur. Kosova, madje, është vonuar. Të gjitha këto gjëra - përdorimi i dinarit serb apo strukturat paralele - janë të dizajnuara nga Serbia për të minuar statusin sovran të Kosovës. Unë, thjesht, nuk i shoh serbët të gatshëm që të heqin dorë prej tyre, pa një goditje të madhe. Ndaj, kthehem te pika ime thelbësore: derisa në Beograd nuk ka një vendim politik për pranimin e sovranitetit të Kosovës, unë nuk shoh rrugëdalje, gjithçka tjetër është çështje dytësore.

E si e shini ju zgjidhjen për veriun e Kosovës?

Frank Wisner: Kjo është një pyetje e komplikuar, sepse veriu i Kosovës është i banuar me serbë, por është pjesë e Kosovës sovranë dhe duhet të integrohet në institucionet e shtetit të Kosovës. Kjo nuk ka ndodhur plotësisht, sepse Serbia e saboton atë integrim.

“Ballkani Perëndimor s’do të jetë prioritet i administratës Trump”

Në Shtetet e Bashkuara pritet ta marrë detyrën një administratë e re. Ka shumë çështje në botë që do të tërheqin vëmendje të menjëhershme, por si e shihni ju angazhimin dhe qasjen e

administratës së re ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor?

Frank Wisner: Nuk e di. Mendoj se është herët të flitet. Ballkani Perëndimor nuk do të jetë prioritet kryesor i politikës së jashtme në administratën e re. Administrata e mëparshme e Trumpit ka pasur një sërë idesh, që synonin arritjen e një marrëveshjeje territoriale. Mendoj se ato kanë dështuar. Nëse administrata e re do t’u kthejë atyre ideve, mendoj se do të dështojë sërisht. Nëse vini në shqyrtim integritetin territorial të vendeve, ju hapni Kutinë e Pandorës, hapni një krizë në të gjithë rajonin, ku shtetet e Ballkanit dhe etnitë e tyre kacafyten se ku duhet të vihen kufijtë. Serbia ka folur për rikrijimin e një Serbie të madhe, që do të ishte mallkim për stabilitetin në Ballkan. Çdo lëvizje drejt këtij objekti, nuk do të shkaktonte gjë tjetër veçse telashe në Ballkanin Perëndimor. Shpresoj që kjo nuk do ta tundojë administratën e re.

Deri në çfarë mase do të angazhohet administrata e re në marrëdhëniet Kosovë - Serbi?

Frank Wisner: Siç e thashë edhe më parë, është ende herët të parashikohet. Personeli i saj nuk ka kaluar ende në Senat dhe nuk i ka definuar politikat. Ka peshq më të mëdhenj për t’u

gatuar, në kuptimin e sfidave të administratës së re në Azi, në Ukrainë dhe në Lindje të Mesme. Të gjitha këto çështje duhet të adresohen, përpara se të shihet ndonjë perspektivë përparimi në Ballkanin Perëndimor.

Si duhet të pozicionohet Qeveria e ardhshme e Kosovës përballë administratës së re në Shtetet e Bashkuara?

Frank Wisner: Mendoj se duhet të sigurohet që linjat e saj të komunikimit janë të hapura, të vazhdojë këmbënguljen në pavarësinë e shtetit dhe të bashkëpunojë me çdo iniciativë të arsyeshme negociuese që ndërmerret.

“Kosova duhet të jetë kandidatë për anëtarësim në NATO”

Me rritjen e tensioneve në Ballkan dhe me rritjen e ndikimeve të huaja nga Rusia dhe Kina, sa e cenueshme është Kosova ndaj përpjekjeve destabilizuese?

Frank Wisner: Kosova është një shtet i vogël. Nuk ka struktura të fuqishme dhe nëse ka synime të vendosura nga jashtë për ta destabilizuar atë, ajo është e cenueshme. Megjithatë, deri më tani, ka mbijetuar dhe kjo më jep shpresë për të ardhmen.

A duhet t’i ofrohet Kosovës një rrugë e qartë drejt anëtarësimit në NATO dhe a do të ndikonte ajo në stabilitetin në rajon?

Frank Wisner: Sipas mendimit tim, Kosova duhet të jetë kandidatë për anëtarësim në NATO dhe kjo do të shtonte një arsye më bindëse që rajoni ta pranonte atë, që Serbia ta pranonte sovranitetin e Kosovës.

Çfarë këshillash do t’u jepnit udhëheqësve të Kosovës dhe të Serbisë, por edhe komunitetit ndërkombëtar lidhur me mosmarrëveshjet në këtë rajon?

Frank Wisner: Mënyra e vetme për t’u marrë me mosmarrëveshjet në rajon, është të flitet për to dhe të adresohen ato. Për shembull, unë nuk pres që Serbia ta pranojë pavarësinë e Kosovës. Ajo duhet, por nuk do ta bëjë. Ato që mund të ndodhin, janë marrëveshjet e pjesshme për tregtinë, për lëvizjen e njerëzve, për bashkëpunimin kulturor. Këta do të ishin hapa praktikë për bashkëpunimin ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe ia vlen të ndiqen. Pra, do të thosha se është një histori e përzier. Ajo nuk ka arritur gjithçka që ka dëshiruar por, sigurisht, e ka ndërtuar veten si një shtet sovran në familjen evropiane.



Krasniqi, Abdixhiku dhe Haradinaj presin në takim lamtumirës ambasadorin Hovenier



PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur në takim lamtumirës ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier. “Në emrin tim dhe të Partisë Demokratike të Kosovës, ambasadorit Hovenier i shpreh mirënjohje për kontributin e jashtëzakonshëm në procese dhe situata sfiduese për Kosovën. Me këtë rast, ia dhurova fotografinë tonë të përbashkët nga takimi ikonik i vitit 2010, si pjesë e delegacioneve të kryeministrit të atëhershëm Hashim Thaçi dhe nënpresidentit Joe Biden. Po ashtu, ia dhurova edhe

Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës për ta falënderuar për angazhimin e tij të palodhur në avancimin e interesave të përbashkëta mes shteteve tona. Ishte kënaqësi të bashkëpunojmë në këtë rrugëtim. Suksese të mëtejme miku ynë!”, ka thënë Krasniqi. Ambasadorin e ShBA-së, Jeffrey Hovenier, e ka pritur në takim lamtumirës edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku. “E falënderova për gjithë angazhimin e gjithë përkushtimin e tij, jo vetëm si ambasador, por dhe si përfaqësues amerikan i viteve të shpalljes së pavarësisë. Jeff ka qenë njohës i mirë i Kosovës, ka qenë përfaqësues i mirë i

interesave strategjike të ShBA-ve në Kosovë; dhe mbi të gjitha kujdestar i përkushtuar i relacioneve mes dy popujve! Jeff, ka qenë pasionant i futbollit kosovar. Kemi ndjekur bashkë

lojëra të shumta të Kombëtares së Kosovës. Në LDK u kujdesëm që si gjysh i 6 mbesave e 1 nipë që është - me të kthyer në shtëpi, t'u dhurojë atyre nga një fanellë të kombëtares sonë me emrat e



tyre në to. T'i mbajnë si kujtim të përhershëm nga shteti i fundit ku ai shërbeu si ambasadorë. LDK pret të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë dhe historik me ambasadorin e ri të administratës së re, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sepse lidhja jonë është ideologjike, është institucionale, është afatgjate - tash e 35 vjet!”, ka shkruar në “Facebook” Abdixhiku.

Ambasadorin amerikan është pritur në takim lamtumirës edhe nga kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj. “Jeffrey Hovenier, ka qenë shumë më shumë se sa Ambasador. Ai ishte mik, partner e kontribuues i jashtëzakonshëm i afrimit të Kosovës me Amerikën dhe Amerikës me Kosovën. E jashtëzakonshme ka qenë ndihma e tij edhe në kapërcimin e sfidave me të cilat jemi përballur gjithë këto vite si dhe në forcimin e demokracisë në vend. Për kontribut të jashtëzakonshëm në forcimin e marrëdhënieve dhe miqësisë midis popullit të Kosovës dhe atij amerikan, ambasadorit Hovenier, sot i kam ndarë mirënjohjen ‘Me besim në Zot, Atdhe e Shtet’”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Kosova merr kryesimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor (WBF)

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Më 18 dhe 19 dhjetor 2024 në Tiranë u zhvillua takimi i radhës i Këshillit të Zyrtarëve të Lartë të Fondit të Ballkanit Perëndimor (WBF). Krahas përfaqësuesve të ministrive të jashtme të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor, Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës në këtë takim u përfaqësua nga udhëheqësi i Divizionit për Rajon, Kenan Tora. Gjatë këtij takimi, sipas radhës, kryesimi njëvjeçar me organizatën e Fondit të Ballkanit Perëndimor nga Bosnjë-Hercegovina kaloi te Kosova. Me këtë rast, Tora shprehu vlerësimin për punën që është bërë në kuadër të organizatës gjatë vitit që po lëmë pas, si dhe nevojën që të



bëhet më tepër për ta avancuar qëndrueshmërinë institucionale të organizatës dhe, gjithashtu, kapacitetet e saj për të pasur ndikim afatgjatë në fushat e

aktiviteteve të saj. Ai nënvizoi se “Kosova e ka dëshmuar veten që është një partner e besueshme në bashkëpunimin rajonal duke marrë pjesë aktive në

mekanizmat rajonalë, përfshirë në këtë rast edhe WBF-në. Për Kosovën, vlerat, parimet dhe standardet evropiane duhet të jenë parimet udhëheqëse në bashkëpunimin rajonal, kurse objektivi final është integrimi në Bashkimin Evropian”. Gjatë kryesimit të WBF-së, Kosova do të angazhohet për të garantuar barazi në mes të anëtarëve si dhe transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet. Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF) është një organizatë ndërkombëtare e vendosur në Tiranë, Shqipëri, e themeluar nga qeveria e Shqipërisë, e Bosnjë-Hercegovinës, e Kosovës, e Maqedonisë së Veriut, e Malit të Zi dhe e Serbisë. Fondi është bërë funksional më 1 tetor 2017,

pas përfundimit të procedurave të ratifikimit të marrëveshjes për themelimin e tij nga të gjitha parlamentet e anëtarëve të tij. WBF synon të promovojë bashkëpunimin dhe vlerat e përbashkëta midis qytetarëve, shoqërisë civile dhe kontaktet mes njerëzve, duke siguruar financime për projekte të vogla dhe të mesme në fushat e aktiviteteve të saj. Kurse Këshilli i Zyrtarëve të Lartë i WBF-së përbëhet nga zyrtarë të lartë të ministrive të jashtme të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat janë anëtare në këtë organizatë, ose përfaqësues të tjerë të emëruar nga këto shtete, dhe mbledhet të paktën një herë në gjashtë muaj.

Osmani dekoroi me Urdhrin e Pavarësisë kryetaren e ndjerë të Senatit belg, Anne Marie Lizin

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Gjatë vizitës së punës në Belgjikë të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në ambientet e Ambasadës së Republikës së Kosovës është organizuar një ceremoni për dorëzimin e Urdhrit Presidential për kryetaren e ndjerë të Senatit Belg, Anne Marie Lizin. Me këtë rast, presidentja Osmani ia ka

dorëzuar Urdhrin e Pavarësisë (post mortem) bashkëshortit të zonjës Lizin. Në prani të familjarëve dhe miqve të ngushtë, presidentja Osmani ka theksuar se kjo është vetëm një dëshmi e angazhimit të saj të palëkundur ndaj vlerave të lirisë, demokracisë dhe pavarësisë së Kosovës. “Kontributet

jashtëzakonshme të Anne Marie Lizin kanë lënë një gjurmë të pashlyeshme në kombin tonë dhe përkushtimi i saj ndaj popullit tonë nuk do të harrohet kurrë. Ndonëse ajo nuk është më me ne, shpirti dhe puna e saj vazhdojnë të na frymëzojnë ndërsa ndërtojmë një Kosovë më të fortë”, ka thënë Osmani.



KMDLNj-ja reagon për rastet e fundit të kërcënimit për vrasje në Kosovë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka bërë me dije se brenda një qarku kohorë prej 24-orësh, nga persona me identitet real apo të sajuar, janë kërcënuar me vrasje gazetarët Ilir Mirena dhe Berat Buzhala, si dhe ish-kryeministri i Kosovës dhe luftëtari i orëve të para të UÇK-së, Ramush Haradinaj. Sipas KMDLNj-së, deri më tani nuk pati asnjë reagim zyrtar apo institucional ose njoftim nga organet e sigurisë për këto kërcënime që për qëllim kanë frikësimin e veprimit opozitar, atij politik si dhe të gazetarisë. "Këto

kërcënime po ripërsëriten në kohën e fushatave zgjedhore si dhe gjatë proceseve, me rëndësi për Kosovën dhe qytetarët e saj. Përballja joparimore midis pozitës dhe opozitës po krijon një mjedis toksik ku fjala e lirë dhe veprimi opozitar, si të drejta elementare të njeriut e që mbrohen, së paku deklarativisht nga ligji në Kosovë, seriozisht po e rrezikojnë përcaktimin dhe veprimin demokratik për të cilin janë deklaruar pozita dhe opozita. KMDLNj e dënon çdo kërcënim që e rrezikon veprimin politik opozitar dhe të pozitës sikur edhe punën e gazetarëve", thuhet në reagimin e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, liria e punës, fjalës dhe shprehjes



janë të garantuara dhe, si të tilla, janë të pacenueshme. "KMDLNj kërkon hetime të shpejta dhe marrjen e masave në përputhje me ligjin si kusht për parandalimin e kërcënimeve tjera dhe krijimin e kushteve për aktivitet politik

pavarësisht përkatësisë politike. KMDLNj shfaq brengosje të thellë për kërcënimin e vazhdueshëm të gazetarëve në përpjekje për të penguar apo pamundësuar informimin objektiv që është edhe misioni kryesorë i

gazetarisë. KMDLNj fton Prokurorinë e Shtetit që të caktojë një ekip emergjent të prokurorëve, sidomos gjatë fushatës që do të reagojë ex-officio kundër kërcënuesve dhe dhunuesve të lirisë së fjalës dhe aktiviteteve politike ndryshe përshkallëzimi i dhunës, fillimisht verbale do të përfundojë me dhunë fizike. Policia e Kosovës ka kapacitete të bollshme profesionale të pengojë dhe arrestojë dhunuesit, pavarësisht se kush janë ata. Politikanët duhet ta respektojnë kodeksin e mirësjelljes duke dhënë kontribut konkret për ulje të tensioneve gjatë fushatës, ditën e zgjedhjeve dhe në kohën e tranzicionit institucional pas zgjedhjeve", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

IPK-ja: Rriten ankesat e qytetarëve ndaj zyrtarëve policorë

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Inspektorati Policor i Kosovës ka pranuar rreth 21 % më shumë ankesa nga qytetarët për zyrtarët policorë krahasuar me vitin e kaluar. Sipas këtij institucioni, ankesat vijnë kryesisht si rezultat i "keqkomunikimit në mes të zyrtarëve policorë dhe qytetarëve e që në disa raste përfundon me përdorim të forcës". Nga këto raste, IPK-ja ka rekomanduar suspendimin e rreth 85 zyrtarëve policorë. Gjatë këtij viti IKP-ja ka pranuar rreth 1 900 ankesa për punën e policëve, thotë për "KosovaPress", kryeshefi i këtij institucioni, Kushtrim Hodaj. "Edhe këtë vit kemi pasur një rritje të numrit të ankesave të qytetarëve ndaj punës së policisë. Kemi rreth 21 % ankesa më shumë këtë vit sesa vitin e kaluar. Deri më tani, që prej



janarit, kemi pranuar rreth 1 900 ankesa. Ndoshta deri në fund të vitit do të kalojë numrin 2 000 të ankesave të qytetarëve ndaj policisë për çështje dhe aspekte të ndryshme që ata mendojnë që të drejtat e tyre janë shkelur apo cenuar nga zyrtarët policorë", thotë ai. Gjatë vitit 2024 IPK-ja ka rekomanduar suspendimin e 85 zyrtarëve policorë, ndërkaq 21 të tjerë janë arrestuar. Hodaj thotë se gjatë kësaj periudhe kanë ngritur edhe 83 kallëzime penale. "Një prej ankesave më të shpeshta është

tejkalmi i përdorimit të forcës. Ka komunikim jo të duhur në mes të policëve dhe qytetarëve. Pastaj ka ankesa për keqpërdorim të detyrës zyrtare, ka ankesa që lidhen me marrjen e rryshfetit dhe raste të tjera të natyrave të ndryshme, duke përfshirë aksidente ku përfshihen zyrtarët policorë, mënyrën e trajtimit të rasteve, vonesat e trajtimit të rasteve. Ne kemi rekomanduar suspendimin e rreth 85 zyrtarëve policorë në raste të ndryshme të cilat kemi zhvilluar hetime penale. Janë arrestuar 21 zyrtarë policorë dhe disa qytetarë që kanë qenë në raste të përbashkëta të të dyshuarve me zyrtarë policorë. Kemi ngritur 83 kallëzime penale, dhjetëra raporte të veçanta dhe raporte informuese i kemi dorëzuar në prokuroritë kompetente", ka theksuar kryeshefi i IPK-së.

Altin Krasniqi, kandidat për deputet, publikon foto me miqtë e babait

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Djali i Jakup Krasniqit, Altini, është kandidat për deputet në listën e PDK-së. Ai në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, në listën e PDK-së për deputet, mban numrin 20. Altini në "Facebook" ka publikuar një fotografi, ku tregon se ndodhet mes personaliteteve të ndritura, miqve të babait dhe miqve të

tij të dashur. "Është një nder dhe emocion i veçantë të jem mes personaliteteve të ndritura, miqve të babait dhe miqve të mi të dashur. Sot, me zemër të plotë dhe besim të patundur, po ecim së bashku drejt një të ardhmeje që na frymëzon dhe na bashkon një të ardhme #mëMirë!", ka shkruar Krasniqi.



Organizohet punëtorja për rishikimin e Strategjisë së Integruar të Policimit

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Me mbështetjen e misionit të OSBE-së, Policia e Kosovës organizoi punëtorinë njëditore për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë së Integruar të Policimit të Drejtuar nga Inteligjenca dhe Planit të Veprimit 2021-2025, e cila përmban 5 objektiva strategjike, 27 nën objektiva dhe 99 aktivitete. Ky është vlerësimi i katërt vjetor dhe qëllimi i tij është t'u ofrojë pjesëmarrësve një pasqyrë të progresit aktual për aktivitetet gjatë vitit 2024, si dhe i njëjti do të përdoret për t'i identifikuar vështirësitë

gjatë zbatimit të planit të veprimit dhe për të nxjerrë rekomandime për zbatim në të ardhmen. Në këtë punëtori me një fjalë hyrëse pjesëmarrësve iu drejtua drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, i cili e vlerësoi mjaft të rëndësishëm dhe të nevojshëm zbatimin e kësaj strategjie, e cila vlerësohet bazë për zbatimin edhe të strategjive të tjera të cilat ndihmojnë, lehtësojnë dhe avancojnë punën e Policisë së Kosovës, në veçanti bashkëpunimin dhe partneritetin me komunitetin, si çelës i rritjes së

vazhdueshme të sigurisë, integritetit, imazhit dhe besimit policor në vend. Në takim u kërkuar që kjo strategji të zbatohet dhe të monitorohet si e tillë, si dhe të planifikohet për vazhdimin e saj në të ardhmen. Anëtarët e grupit punues të PK-së bënë një përmbledhje mbi zbatimin e planit të veprimit brenda detyrave sipas kompetencës së departamenteve dhe drejtorive policore. Pjesë e kësaj punëtorie ishin edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Inspektoratit Policor të Kosovës, misionit të



OSBE-së në Kosovë, ICITAP-it, UNDP-së dhe drejtorët e divizioneve e të drejtorive

rajonale të PK-së, të cilët kontribuuan me komentet dhe rekomandimet e tyre.

Mandarinat nga Shqipëria, me mbetje të pesticideve të rrezikshme

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Mandarinat me origjinë nga Shqipëria kanë rezultuar me mbetje të pesticideve të rrezikshme Chlorpyrifos dhe Phosmet, ka bërë me dije Sistemi Evropian i Sigurisë Ushqimore (RASFF).

Këto substanca, të ndaluara për përdorim në Bashkimin Evropian, paraqesin rreziqe serioze për shëndetin e njeriut. Lidhur me këtë nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) kanë bërë me dije për "Telegraf"-in se janë duke e monitoruar situatën e njohimeve të dërguara nga RASFF për vendet e tjera për gjetje të pranishme të pesticideve

mbi nivelet e lejuara në produktin mandarina (mandarina/clemantina te fërkata) me orgjinë nga Shqipëria.

Zëdhënësi i AUV-it, Lamir Thaçi, theksoi se AUV ka ngritur masat e nivelit të kontrollit. "AUV nga mbrëmë ka ngritur masat e nivelit të kontrollit për ngarkesat me llojin e produktit mandarinë. Të gjitha kontingjentet apo ngarkesat me këtë produkt, përveç kontrollit inspektues të detajuar, merren mostra nga secila për testim laboratorik me qëllim testimi/përcaktimi të nivelit të mbetjeve në pesticide përfshihet (lloji parametri i

dyshuar për testim (MRL) në Chlorpyrifos dhe phosmet). Ngarkesat qëndrojnë në pikë kontrollit kufitare deri në rezultatet e analizave laboratorike", tha Thaçi.

Ai shtoi se përderisa Kosova nuk është e përfshirë në lajmërimet e RASFF, masën e vendosur e bëjnë me qëllim të eliminimit të dyshimeve të ngritura. "Synim kryesor të punës sonë, që buron edhe nga mandati ligjor, kemi mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve konsumatorë. Deri më tani nuk ka pasur asnjë element dyshues mbi këtë produkt. Jemi në kontakt me autoritetet shqiptare në shkëmbim të



informacioneve mbi secilën risi që ndodh në gjetjet eventuale në produkte. Mbrojtja e konsumatorëve bëhet pa dallim", ka thënë Thaçi. Ministria e Bujqësisë e

Shqipërisë ka bërë me dije se bëhet fjalë për tri ngarkesa me mandarina 'Clementine', të eksportuara nga subjektet grumbulluese ushqimore me vendndodhje në Berat dhe Fier.

65 % e territorit dhe 82 % e popullsisë janë në rrezik nga përmbytjet lumore

Kryeministri Albin Kurti në konferencën përmblylëse të projektit "Promovimi i qasjes universale në ujë të pastër" ka thënë se menaxhimi, mbrojtja e burimeve ujore dhe rritja e kapaciteteve tona ujore janë prioritetet shtetërore

EPOKA E RE


Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në konferencën përmblylëse të projektit "Promovimi i qasjes universale në ujë të pastër", organizuar nga Rilindja e Gjellbër dhe financiar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Në këtë konferencë kryeministri shprehu mirënjohjen e tij të thellë ndaj Rilindjes së Gjellbër dhe Zyrës së Bashkimit Evropian për bashkëpunim në këtë iniciativë, që njëherësh është edhe dëshmi e angazhimit tonë të përbashkët për një të ardhme më të mirë. "Për ne si qeveri çështja e ujit nuk është vetëm një problem teknik i furnizimit, por një sfidë strategjike që lidhet drejtpërdrejt me ndryshimet klimatike dhe me të ardhmen e ekonomisë dhe mirëqenies së qytetarëve tanë. Ne të gjithë këtu jemi të

vetëdijshëm se Kosova përballet me një realitet të ashpër. Ne kemi resurse të kufizuara të ujit dhe jemi ndër vendet me sasinë më të vogël të ujit në rajon. Prandaj, menaxhimi, mbrojtja e burimeve ujore dhe investimet konkrete për t'i rritur kapacitetet tona ujore janë prioritetet shtetërore", u shpreh ai.

Teksa foli për ndryshimet klimatike, kryeministri theksoi se sot 65% e territorit dhe 82% e popullsisë janë në rrezik nga përmbytjet lumore. Ai përmendi përmbytjet e viteve 2013, 2014 dhe 2016 që shkaktuan dëme të drejtpërdrejta mbi katër milionë euro, ndërsa thatësitat e përsëritura kanë shkaktuar mungesa ujore në 80% të komunave tona.

Kryeministri veçoi hapat që qeveria ka ndërmarrë për t'iu përgjigjur kësaj situatë kritike, ku brenda dy viteve janë trefishuar stacionet hidrologjike



dhe meteorologjike, duke krijuar një sistem të avancuar paralajmërimi të hershëm për përmbytje dhe thatësira, janë nisur projekte të rëndësishme për ndërtimin e rezervuarëve të rinj si në Firajë, Shtime dhe Pollata e shumë të tjerë, që do t'i rrisin kapacitetet ujore mbi 204 milionë m³ ujë, duke siguruar furnizim për ujë të pijshëm dhe për bujqësi.

Në adresimin e tij para të pranishmëve, kryeministri foli edhe për Strategjinë Shtetërore për Ujërat, e cila përfshin sfidat e ndryshimeve klimatike dhe

ndërtimin e një qëndrueshmërie afatgjatë. Po ashtu janë përmirësuar e rritur kapacitetet në Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore dhe janë pajisur komunat me harta të avancuara të rrezikut nga përmbytjet për të ndihmuar planifikimin dhe reagimin e shpejtë, si dhe kanë përfunduar investimet tona në impiante të ujërave të zeza në Pejë, Gjakovë dhe Prizren, teksa projekte të tjera për trajtimin e ujërave të zeza janë akoma brenda listës prioritare të qeverisë e të cilat do të zbatohen. Të gjitha këto do

të kontribuojnë jo vetëm në uljen e ndotjes, por edhe në rritjen e kapacitetit për përdorimin e ujit të pastër për pije dhe ujitje, u shpreh kryeministri Kurti.

Në fund të fjalës së tij ai tha se qasja në ujë të pastër është çështje drejtësie dhe mbijetese për qytetarët tanë dhe se ky projekt që po përmbillet sot është dëshmi e përkushtimit tonë të përbashkët për të mbrojtur këtë burim jetik dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme në këtë epokë të sfidave klimatike.

Aliu: Mjegulla dhe moti i keq nuk ndalojnë më fluturimet falë teknologjisë së re në Aeroportin e Prishtinës

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka theksuar se edhe në kushte të vështira atmosferike trafiku ajror në Kosovë vazhdon të funksionojë pa ndërprerje. Ai ka thënë se kjo po bëhet falë investimeve të qeverisë në

sistemin e avancuar të aterimit ILS CAT 3B. Aliu në "Facebook" shtoi se ky sistem ka eliminuar ditët kur fluturimet anuloheshin për shkak të mjegullës dhe motit të keq, duke mundësuar që fluturimet të realizohen pa vonesa dhe ndërprerje. "Edhe në këto kushte të vështira

atmosferike, trafiku ajror vazhdon të funksionojë pa ndërprerje falë investimeve të Qeverisë së Kosovës në sistemin e avancuar të aterimit - ILS CAT 3B. Ditët kur fluturimet anuloheshin për shkak të motit të keq me mjegull kanë mbetur tashmë histori", ka shkruar ministri Aliu.



Sindroma e Kalorësit të Bardhë: Ai që shpëton të tjerët



Sindroma e Kalorësit të Bardhë është një fenomen që prek shumë njerëz, veçanërisht ata që kanë përjetuar braktisje apo trauma në të kaluarën. Dëshira e tyre për të shpëtuar të tjerët është thujse e pakontrollueshme, edhe pse shpesh kjo ndihmë nuk është gjithmonë ajo që të tjerët kërkojnë ose kanë nevojë.

Kjo sindromë përfaqëson ata individë që ndjejnë nevojën e pashmangshme për të ndihmuar, për të zgjidhur problemet e të tjerëve dhe për të shëruar plagët e tyre emocionale. Rrënjët e këtij fenomeni shpesh lidhen me përvojat të dhimbshme, trauma apo mungesë dashurie të ndërsjellë. Një element kyç i këtyre personave është aftësia e jashtëzakonshme për të ndjerë dhimbjen e të tjerëve, por ndonjëherë ndihma që ofrojnë vetëm sa e përkeqëson situatën.

Të gjithë kemi njohur të paktën një "shpëtimtar" të lindur – dikë që duket sikur ka një radar emocional për të perceptuar nevojat e të tjerëve. Por kjo ndihmë mund të bëhet e tepruar dhe ndonjëherë invazive, duke i lënë ata që ndihmohen të ndihen të paaftë për të

zgjidhur vetë problemet e tyre. Në anën tjetër, altruizmi i sinqertë dhe devotshmëria e kalorësit të bardhë shpesh është burim falënderimi. Megjithatë, prapa kësaj sjelljeje fshihet një realitet i dhimbshëm dhe plagë të pashëruara.

Sindroma e Kalorësit të Bardhë u përshkrua për herë të parë në vitin 2015 nga psikologjet Mary C. Lamia dhe Marilyn J. Krieger nga Universiteti i Berkeley-t. Le t'i hedhim një vështrim më të hollësishëm këtij fenomeni.

Karakteristikat e sindromës së Kalorësit të Bardhë

Në përralla, kalorësi mbi një kalë të bardhë shpëton princshën nga rreziku. Në jetën reale, kalorësi i bardhë mund të jetë burrë apo grua, dhe qëllimi i tij është të ndërtojë marrëdhënie me njerëz të lënduar apo vulnerabël. Duke shëruar tjetrin, ai apo ajo përpiqet të forcojë vetveten dhe të ndiejë se ka dhënë kuptim jetës. Megjithatë, shpesh ndodh që personat e lënduar nuk shërohen plotësisht. Në vend të kësaj, plagët e tyre bëhen reflektime të dhimbjeve dhe

traumave gjithnjë e më të mëdha të kalorësit të bardhë. Ky cikël frustrues shpesh përfundon me pakënaqësi dhe vuajtje.

Shkaqet

Faktorët që shpesh çojnë në zhvillimin e kësaj sindrome përfshijnë:

Një fëmijëri të mbushur me abuzime apo prindër autoritarë.

Mungesë e lidhjeve të shëndetshme emocionale.

Përvoja të shumta braktisjeje, si nga familja, ashtu edhe nga partnerët romantikë.

Sjelljet tipike të Kalorësit të Bardhë

Frika nga braktisja: Kalorësi i bardhë ka një frikë të thellë nga distanca emocionale dhe braktisja.

Ndjeshmëri e lartë ndaj zhgënjimeve: Ata priren të ndihen të ofenduar apo të dëshpëruar nga situata, që për të tjerët mund të duken të parëndësishme.

Vlerësim i ulët për veten: Ata luftojnë me pasiguri të thella dhe mungesë vetëbesimi.

Mungesa e kufijve emocionalë: Kalorësit të bardhë shpesh dështojnë të

dallojnë mes ndjenjave të tyre dhe të tjerëve, duke i intensifikuar shpesh dhimbjet e personit që përpiqen të ndihmojnë.

Varësi emocionale: Në marrëdhënie dashurie, ata tentojnë të jenë tepër të varur, duke u përpjekur të jenë gjithçka për partnerin e tyre.

Llojet e Kalorësve të Bardhë

Sindroma e kalorësit të bardhë përfshin një spektrum sjelljesh, nga ato më të zakonshmet deri te ato më patologjike:

Kalorësi empatik: Këta njerëz zhvillojnë lidhje emocionale të thella me ata që ndihmojnë, por shpesh përfundojnë duke përjetuar xhelozitë dhe dëshirë për kontroll.

Kalorësi idealist: Ky lloj kërkon të "krijojë" një individ të përsosur, duke u ndjerë krenar për sukseset e veta.

Kalorësi i frikësuar: Ky tip ka përjetuar trauma të rënda dhe shpesh nuk di si të ndihmojë apo të krijojë lidhje të shëndetshme.

Kalorësi i ekuilibruar: Këta njerëz ndihmojnë me respekt dhe kujdes, por përsëri

përjetojnë një nevojë të brendshme të pakontrolluar për të shpëtuar të tjerët.

Shpëtimi i vetvetes, zgjidhja për Kalorësin e Bardhë

Ndërhyrja më e madhe dhe më e guximshme për një kalorës të bardhë është të shpëtojë veten. Kjo përfshin: Ballafaqimin me plagët emocionale dhe përvojat e dhimbshme të së kaluarës.

Kërkimin e ndihmës nga një profesionist i shëndetit mendor për të ndihmuar në trajtimin e traumave.

Ndërtimin e kufijve të shëndetshëm emocionalë për të shmangur ndjesinë e mbingarkesës dhe humbjes së identitetit.

Ndihma për të tjerët është një akt fisnik, por nuk duhet të ndodhë kurrë me koston e mirëqenies personale. Duke zgjedhur të përqendrohet te vetja, kalorësi i bardhë mund të krijojë marrëdhënie më të shëndetshme dhe më të lumtura, si për veten, ashtu edhe për ata që ndihmon.

Në fund të fundit, çdo kalorës duhet të kuptojë se armiku më i madh që duhet të përballojë ndodhet brenda vetes. / bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 PILKINGTON
 Inveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Sot përballja Llapi - Dukagjini, katër ndeshjet e tjera në fundjavë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Xhiroja e 18 në Superligën e Kosovës në futboll fillon sot (e premte) me ndeshjen në mes të Llapit dhe Dukagjinit nga Klina. Dy ndeshje të tjera të xhiros së fundit për sezonin vjeshtor zhvillohen të shtunën dhe dy të tjera të dielën. Skuadra e Llapit, që është në një krizë rezultatesh, ku në dhjetë ndeshjet e fundit është pa fitore, synon që ndaj Dukagjinit të marrë tri pikë dhe shkon në pushim me fitore. Në anën tjetër as klubi nga Klina nuk ka pasur rezultatet e pritura në këtë sezon dhe në këtë ndeshje do të luajë të paktën për një barazim. Kjo ndeshje zhvillohet në stadiumin "Zahir Pajaziti" nga ora



13:00. Nesër (e shtunë) do të jetë një ndeshje derbi në stadiumin "Fadil Vokrri" ku Prishtina e pret skuadrën në formë të mirë, Malishevën. Të këto dy klube do të përpiqen ta marrin maksimumin e pikëve në këtë ndeshje. Po të njëjtën ditë përballen edhe Ferizaj dhe Gjilani. Gjilani me fitoren e fundit në xhiron e kaluar ndaj Dritës ka rikthyer besimin për rezultate pozitive, kurse Ferizaj është në vendin e parafundit dhe ka vetëm 17 pikë. Një tjetër ndeshje derbi zhvillohet të dielën

mes dy skuadrave nga qyteti i Suharekës, Suharekës dhe Ballkanit. Kampionët janë në vendin e dytë me 30 pikë, kurse Suhareka është në vendin e pestë me një diferencë prej pesë pikësh. Ndeshja tjetër është në mes të Feronikelit '74 dhe Dritës. "Nikli" në tri ndeshjet e fundit ka regjistruar rezultate pozitive dhe këtë do të përpiqet ta bëjë edhe ndaj lideres aktuale, Dritës. Gjilanasit në anën tjetër presin t'u rikthehen fitoreve pas humbjes në xhiron e kaluar.

SUPERLIGA - Java e 18

Të premten takohen:
 13:00 Llapi - Dukagjini

Të shtunën takohen:
 Ferizaj - Gjilani
 Prishtina - Malisheva

Të dielën takohen:
 Suhareka - Ballkani
 Drita - Feronikeli '74

SHKURT

Prishtina e mbyll vitin me fitore

Prishtina e ka fituar ndeshjen e parë të xhiros së 14-t të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Është kjo xhiroja e fundit për këtë vit. Skuadra prishtinase të mërkurën mbrëma fitoi në Shtime ndaj Vjosës me rezultat 40:34. Oltion Beshiri ishte më efikas te Prishtina me 14 gola. Gjashtë i kishte Altin Cacaj e nga pesë Albi Gjuka e Gent Bajrami. Te Vjosa, Festim Mustafa vazhdoi me efikasitet të lartë. I shënoi 13 gola. Gjashtë i kishte Endrit Tafarshiku, sa edhe Erblin Qerimi. Stinorin vjeshtor Prishtina e përfundon në vendin e katërt me 16 pikë. Vjosa dimëron me tetë pikë, ndërsa momentalisht mban pozitën e gjashtë. Tri ndeshjet e tjera të javës së 14-t zhvillohen të enjten.

KB Trepça ndan rrugët me Desmond Cambridge

KB Trepça ka njoftuar se ka ndarë rrugët me basketbollistin Desmond Cambridge. Marrëveshja për shkëputje të bashkëpunimit thuhet se është bërë në mënyrë të dyanshme. "Në emër të klubit i urojmë çdo të mirë dhe shumë suksese në vazhdimin e karrierës së tij profesionale", thuhet në njoftimin e KB Trepça.

Klubi anglez ofron 3.5 milionë euro për Muçin, Beshiktashi e refuzon

Beshiktashi nuk e ka ndër mend të heqë dorë nga Ernest Muçi. Sipas asaj që shkruajnë mediet turke, klubi i njohur ka refuzuar 3.5 milionë euro nga një skuadër e Championship në Angli. Shifra e ofruar është konsideruar tepër e ulët në krahasim me vlerën reale që ka sulmuesi i Shqipërisë. 23-vjeçari mund të largohet nga Stambolli, në rast të një propozimi, që përmbush pritshmëritë e klubit. Muçi ka luajtur në këtë sezon 11 ndeshje në kampionat, ku ka realizuar tre gola dhe ka dhuruar një asistim. Për të ky është sezoni i dytë te Beshiktashi.

Kosova dy pozita më lart në renditjen e FIFA-s, Shqipëria në vend të njëjtë



Prishtinë, 19 dhjetor - Është publikuar përditësimi i fundit i FIFA-s për vitin 2024 sa i përket renditjes së përfaqësuesve të futbollit në mbarë globin. Kosova ka fituar dy pozicione, duke u ngjitur në vendin e 99. Pra ekipi i drejtuar nga Franco Foda tashmë është mes 100 kombëtareve më të mira. Ndërsa Shqipëria e mbyll vitin në vendin e 65-të, i njëjti pozicion ku ishte një muaj më parë. Sa i përket top-dhjetëshes, në krye është Argjentina, kampione bote në fuqi, e ndjekur nga Franca, Spanja, Anglia dhe Brazili. Në dhjetëshen e parë hyn edhe Kombëtarja e Gjermanisë.

Cana: UEFA nuk duhet të na linte në grup me Serbinë

Shqipëria përballë Serbisë është padyshim sfida që ka marrë vëmendjen në këto kualifikuese për "Botërorin 2026", kjo edhe për shkak të ngjarjeve në të kaluarën dhe të ndjeshmërisë që kanë tifozët. Ish-kapiteni i Kombëtares, Lorik Cana, ka

rrëfyer se çfarë pret nga dy sfidat e ardhshme që do të vendosin dhe fatin e Shqipërisë për një vend në Botëror. "Unë mendoj se çfarë kemi përjetuar ne si komb dhe sidomos pjesa e shqiptarëve në Jugosllavi, mua m'u duk që në herën e

parë diçka jo e logjikshme që të përballen në një grup. Para 10 vitesh i kemi lënë pas në klasifikim dhe është diçka që mund të bëjmë në të njëjtën mënyrë duke qenë se në grup është edhe Anglia që është favoritë për vendin e parë. Në atë kohë më ra të kisha dy

lojtarë serb te Lazio, por edhe në ekipet e tjera dhe kam biseduar me ta. Fakti që s'do ketë tifozë më duket shumë normale sepse askush nuk të garanton rendin dhe sigurinë e tifozëve që do të vijjnë", ka thënë Cana për "TCH".



Vasseur: Leclerci e Hamiltoni do të bashkëjetojnë dhe fitojnë për Ferrarin

MODENA, 19 DHJETOR - Pasi i është afuar fitimit të titullit të konstruktorëve, Ferrari po shikon vitin 2025 në Formula 1 me ambicie të mëdha edhe në lidhje me garën për titullin e pilotëve. Ardhja e Lewis Hamiltonit së bashku me Charles Leclerc kompletton një ekip ëndrrash edhe pse të

kesh dy pilotë kryesorë në të njëjtin ekip mund të krijojë disa probleme menaxhimi. Për drejtorin sportiv të "kokëkuqes" Frederic Vasseur, ky nuk është një problem: "Ata të dy kanë një nivel shumë të lartë, janë të shpejtë, kanë përvojë dhe kanë respekt të ndërsjellë. Krahasimi mes të

dyve do ta përmirësojë performancën. Nuk duhet ta shmangim atë". "Ku fiton një titull gjithçka është ndryshe. Hamiltoni vjen me këtë lloj nevojë për veten e tij, por edhe për ekipin dhe është një gjë e mirë. Për ne është e rëndësishme ta kemi këtë shtytje nga pilotët. Lewisi vjen

me një vizion tjetër dhe jam i bindur se përvoja e Lewisit do të jetë e dobishme", ka shtuar Vasseur. Në lidhje me pritshmëritë e Leclercut, menaxheri francez ka thënë: "Charlesi është ende i ri dhe këtë sezon ka bërë një hap përpara në drejtim të pjekurisë dhe menaxhimit të



garës. Një hap i madh në menaxhimin e vështirësive, pasi duhet të dish ta përballosh pjesën e vështirë të sezonit dhe të reagosh".

Mbappe: Do të më pëlqente të luaj me Ronaldon

MADRID, 19 DHJETOR - Sulmuesi Kylian Mbappe thotë se Cristiano Ronaldo së bashku me Lionel Messin janë legjenda të futbollit, ndërsa do t'i pëlqente të luante pranë portugezitet. Edhe pse vetëm 25 vjeç, Mbappe ka luajtur me disa nga me më të mirët e futbollit, megjithatë jo me atë që është idhulli i tij, Cristiano Ronaldo.



Në një intervistë për "BeIN Sport", Mbappe është pyetur për Ronaldon, ndërsa shprehu dëshirën që të luante pranë tij, edhe pse e pranoi se është e vështirë të ndodhë. "Natyrish që do të më pëlqente të luaj me Cristiano Ronaldon. Është gjithmonë ndjenjë e mirë kur luan me lojtarë të shkëlqyeshëm, siç është ai apo Leo Messi. Kur flasim për Cristianon, flasim gjithmonë edhe për Messin. Por, jam i

kënaqur sepse kam luajtur me shumë lojtarë të mëdhenj: Messi, Neymar, Pogba, Griezmann, Benzema...", ka thënë Mbappe.

Mbappe, ndër të tjera, shtoi se asnjëherë s'ka pritur të luajë me Messin, të cilin e vlerësoi unik njësoi si portugezin. "Mendoj se do të ishte e bukur nëse do të luaja me Ronaldon, por tash është më e vështirë. Kam luajtur kundër tij disa herë.

Është një legjendë e këtij sporti. Kam raport të shkëlqyer me Messin. Nuk e kam menduar kurrë se do të luaja bashkë me të. Është unik si 'CR7' dhe mendoj se ndonjëherë e banalizojmë kur flasim se cili është më i miri. Janë legjenda të sportit". Përndryshe, ai realizoi në fitoren 3:0 ndaj skuadrës mexikane Pachuca, duke ngritur trofeun e dytë që kur iu bashkua Real Madridit.

Shantazhet ndaj familjes së Schumacherit, e përfshirë në krim dhe infermierja e pilotit

WUPPERTAL, 19 DHJETOR - Vazhdon hetimi për shantazhin ndaj familjes së Michael Schumacherit. Që kur shtatë herë kampioni i botës pësoi atë aksident në vitin 2013, të afërmit e tij kanë dashur ta mbajnë private gjendjen e tij shëndetësore. Është një mister se si është legjenda e Formula 1 për momentin, pasi asgjë nuk është zbuluar, por familjes i është dashur të përballon me disa shantazhe që tani janë duke u hetuar. Prokuroria e Wuppertalit është duke hetuar këtë rast shantazhi ndaj familjes së legjendës gjermane dhe në listën e të dyshuarve ka përfshirë edhe një infermiere që merrej me kujdesin e shtatë herë kampionit. Pas deklarimit së njërit prej burrave që



kërkonte shpërbllim nga familja për të mos shpërndarë video dhe pamje të papublikuara të gjendjes aktuale të ish-pilotit të F1, ka dalë emri i një të dyshuarve që do të hetohet për këtë rast. Kjo punonjëse që ishte në shërbim të familjes së Schumacherit duket se ka dështuar në besimin që i është dhënë dhe tani është në kërkim. Ajo duhet të kishte

shkuar për të dëshmuar në seancën e parë të këtij procesi, por nuk u paraqiti dhe tani i është shfaqur sërish emri, por këtë herë si e dyshuar për krimin. Kjo pasi, gjatë ndërhyrjes së njërit prej tre të akuzuarve, ai ka theksuar se infermierja i ka ndihmuar për marrjen e informacioneve, pamjeve dhe videove me të cilat shantazhoni familjen e gjermanit. Kjo ka bërë që më shumë gishta të drejtohen drejt saj si bashkëpunëtore, pasi një nga punonjëset që punon me familjen ka theksuar se dyshuan për infermierin që në momentin e parë të shfaqjes së shantazhit. Tani për tani kanë nisur të kryhen detyra kërkimi për ta hetuar, pasi nuk dihet vendndodhja e saj.

SHKURT

Perezi largohet nga Red Bulli

Sergio Perezi do të largohet nga Red Bulli dy vjet përpara përfundimit të kontratës, pasi arriti një marrëveshje për ndërprerjen e saj me ekipin. Ky vendim vjen pas një sezoni të dobët për mexikanin, i cili nuk arriti të fitojë asnjë garë dhe u ngjiti në podium vetëm katër herë, ndërsa shoku i tij i ekipit, Max Verstappen, fitoi titullin e katërt botëror. Perezi, i cili në thelb është shkarkuar, ka thënë: "Jam jashtëzakonisht mirënjohës për katër vitet e kaluara me Red Bull Racing dhe për mundësinë për të garuar me një ekip kaq të jashtëzakonshëm. Të garosh për Red Bullin ka qenë një përvojë e paharrueshme dhe gjithmonë do t'i çmoj sukseset që arritëm së bashku".

Modriqi në histori të Realit, bëhet futbollisti më i trofeshëm

Mesfushori kroat Luka Modriqi vazhdon ta shkruajë emrin e tij me shkronja të arta në historinë e Real Madridit. Modriqi fitoi trofeun e tij të 28 si lojtar i Real Madridit pas fitores 3-0 ndaj Pachuca në finalen e Kupës Ndërkontinentale FIFA. Ai tani është lojtari më i trofeshëm i "Los Blancos" i të gjitha kohëve, pasi ka fituar më shumë trofe se çdo lojtar tjetër. Mesfushori kroat ka një trofe më shumë se Dani Carvajal, i cili nuk mundi të luante në Kupën Ndërkontinentale për shkak të një dëmtimi. Ai, gjithashtu, ka kaluar me lehtësi lojtarët si Nacho Fernandez, Marcelo dhe Karim Benzema për sa iu përket trofeve të fituara. Modriqi ka fituar gjashtë trofe të Ligës së Kampionëve dhe katër tituj të La Ligës që kur mbërriti te Real Madridi.

Gazeta italiane: Gattuso s'e ka marrë që disa muaj pagën te Hajduku

Hajduku ka shtatë pikë më shumë se Dinamo Zagrebi në luftën për titull në Kroaci dhe gjasat për titull janë rritur. Por "Il Post" në Itali shkruan se, pavarësisht prej suksesit, trajneri Gennaro Gattuso ka disa muaj që nuk ka marrë pagë te gjiganti kroat. "Gattuso ka punuar disa muaj në Hajduk pa pagesë dhe pa shumë siguri. Nuk është hera e parë që i ndodh kjo që kur i është futur punës së trajnerit", thuhet në njoftimin e gazetës italiane.

Ancelotti: Të fitosh tituj te Reali është më e lehtë se kudo tjetër

Pasi u bë trajneri më i dekoruar i klubit në histori me 15 tituj duke mposhtur Pachucan në finalen e Kupës Ndërkontinentale, trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, pas ndeshjes. "Dua të jem i sinqertë. Të fitosh tituj te Real Madridi është më e lehtë se kudo tjetër. Ke një klub fantastik, një bazë tifozësh që shtyn dhe një skuadër me lojtarë më të mirë në botë. Ka qenë një vit fantastik, dhe kemi pasur vështirësi të ndryshme gjatë gjithë vitit, dëmtime. E kemi përfunduar shumë mirë këtë vit, të jem i sinqertë, dhe kjo na jep besimin që na duhej dhe motivimin për të vazhduar me rezultate më të mira në vitin 2025", ka thënë Ancelotti.

Lillard: Ua shpërndamë gjysmë milion dollarë punonjësve të klubit

Basketbollistët e Milwaukee Bucks fituan Kupën e NBA-s dhe secili lojtar mori bonus 514 971 dollarë për çmimin. Dhe ndërsa kjo shifër do të thotë shumë për lojtarët individualë si Stanley Umude, Liam Robbins dhe

Ryan Rollins sepse ata kanë një pagë vjetore prej më pak se 600 000 dollarë, për yjet më të mëdhenj të ekipit është vetëm një "pikë në oqean". Kjo është arsyeja pse Damian Lillard, lojtari më i paguar i skuadrës së

bashku me Giannis Antetokounmpo, vendosi të mos e marrë çmimin, por t'ua shpërndajë atë punonjësve të klubit. Lillard, i cili fiton çdo vit 48 787 676 dollarë, ka thënë se do të dhurojë gjysmë milioni

dollarë për asistentët në ekipin profesional, stafin, higjienistët, kontabilistët dhe punonjësit e tjerë të klubit. "Kam një kohë të gjatë që merrem me këtë sport. Nuk dua ta marr çmimin dhe ta shpenzoj si i çmendur. Lekët do

t'ua jap punonjësve të klubit, njerëzve që punojnë çdo ditë me ne gjithë ditën", ka thënë 34-vjeçari Lillard pas ndeshjes, i cili në finalen e Kupës së NBA-së shënoi 23 pikë në fitoren 97-81 ndaj Oklahoma City.



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

